



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR
INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT**

PËR VITIN 2019

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

“ETIKA Co” Sh.p.k. ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga ETIKA Co shpk, nga Fatmir Mehmeti, udhëheqës i ekipit si dhe Burim Selmani, anëtar i ekipit.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja.....	13
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	15

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore - Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore ishte menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli - kontrollet në IAP lidhur me shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, me përjashtim të mos shfrytëzimit të softuerit e-pasuria në raportimin e pasurive nën 1,000€ në PFV.

Zbatimi i rekomandimeve - IAP prej dy rekomandimeve kishte adresuar një dhe një ishte në proces të adresimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Institucioni i Avokatit të Popullit është pajtuar me gjetjen dhe konkluzionin e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimin e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga IAP-ja. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Avokati i Popullit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të IAP-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrollit në IAP, ka dëshmuar se kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Megjithatë duhet të ndërmerren veprime që të vihet në funksion sistemi e-pasuria, me qëllim që raportimi i pasurive nën 1,000€ në PFV të bëhet nga ky softuer.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,373,754	1,247,363	1,143,429	92%	1,126,242	963,723
Granti i Qeverisë - Buxheti	1,373,754	1,214,593	1,124,234	93%	1,101,032	928,199
Donacionet e jashtme		32,769	19,194	59%	25,210	35,524

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 126,391€. Ky zvogëlim është rezultat i kursimeve buxhetore nga IAP dhe vendimit të Qeverisë Nr 03/115 i datës 07.12.2019.

Në vitin 2019, IAP-ja ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 1,143,429€, me nën shpenzim prej 2% krahasuar me vitin 2018. Megjithatë, se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,373,754	1,247,363	1,143,429	92%	1,126,242	963,723
Pagat dhe Mëditjet	990,901	942,935	942,935	100%	857,897	689,331
Mallrat dhe Shërbimet	309,353	247,928	195,231	79%	211,056	235,219
Shërbimet komunale	25,500	8,500	5,263	62%	12,473	24,525
Investimet Kapitale	48,000	48,000	-	0%	44,816	14,648

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar 47,966€:
- Zvogëlim të buxhetit final kishte edhe te kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 61,425€, si dhe për shërbimet komunale në vlerë 17,000€; ndërsa
- Të kategoria e investimeve kapitale nuk kishte ndryshime buxhetore.

Ky zvogëlim i buxhetit ishte me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr 03/115 të datës 17.12.2019 si dhe kursimeve buxhetore nga IAP-ja.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 942,935€, aq sa edhe ishte shpenzuar. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 81 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 74. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 2 të rinj. Kemi testuar 39 mostra për teste substanciale në vlerë 942,935€, si dhe 21 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 247,928€, ndërsa ishin shpenzuar 195,231€. Te shpenzimet komunale buxheti ishte 8,500€, prej të cilave ishin shpenzuar 5,263€.

Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime për udhëtime zyrtare, shpenzime kontraktuese tjera, dreka zyrtare, mirëmbajtje, qira, botime, shpenzime të telefonit, furnizime për zyre dhe shpenzime tjera. Kemi testuar 43 mostra për teste substanciale në vlerë 57,453€ si dhe 13 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 48,000€, prej tyre në 2019 nuk kishte shpenzuar fare. Shpenzimet kanë qenë të planifikuara për blerjen e tri veturave, mirëpo për shkak që Autoriteti Qendror i Prokurimit (AQP) nuk kishte arritur të realizonte blerjet përmes procedurave të prokurimit, buxheti i IAP-së ka mbetur i pashpenzuar. Andaj lidhur me këtë kategori, nuk kemi asnjë mostër për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë, dhe nuk kemi ndonjë mangësi për raportim.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 75,075€, pasurive jokatitale është 74,563€, si dhe e stoqeve 35,040€. Ne kemi testuar 41 mostra për teste substanciale në vlerë 9,839€ si dhe një mostër për teste të pajtueshmërisë. Lidhur me menaxhimin e pasurive ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e sistemit të E-pasurisë dhe raportimin e tyre në PFV

Gjetja Neni 22 i rreg. Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, përcakton që të gjitha pasuritë kapitale dhe jo kapitale duhet t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Ndërsa neni 24 përcakton që paraqitja në pasqyrat vjetore financiare për pasuritë nën 1,000€ duhet të bëhet nga sistemi e-pasuria me vlerë kontabël neto.

Për shkak të mangësive në sistemin e-pasuria, përkatësisht të migrimit të shënimeve nga platforma e vjetër në platformën e re, IAP në PFV kishte prezantuar pasuritë nën 1,000€ në bazë të kalkulimeve të brendshme (në formatin Excel), pasi e-pasuria nuk ofronte siguri në kalkulimin e saktë të zhvlerësimit. Lidhur me këto shënime, ne kemi kryer testet tona dhe nuk kemi identifikuar ndonjë dobësi.

Arsyeja që IAP kishte vazhduar të përdor për raportim formatin Excel në vend të e-pasurisë edhe përkundër rekomandimit të vitit të kaluar, ishte mos përfundimi i migrimit apo bartjes së shënimeve në platformën e re të e-pasurisë.

Ndikimi Raportimi i pasurive nga formati Excel ndikon që raportimi apo shpalosja e tyre të mos jetë në përputhje me kërkesën e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe që vlera e tyre të mos jetë e saktë në PFV.

Rekomandimi C1 Avokati i Popullit duhet të sigurohet që procesi i migrimit të shënimeve është kryer më qëllim që regjistri e-pasuria të jetë funksional dhe ofron informata të sakta në PFV.

2.3 Detyrimet

2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 1,573€³. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

2.3.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në PFV ishte me vlerë zero.

³ Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar

2.3.3 Detyrimet kontraktuale

Vlera e detyrimeve kontraktuale ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 47,167€⁴. IAP kishte kontrata të cilat ishin nënshkruar nga Autoriteti Qendror i Prokurimit, prej të cilave disa ishin kontrata kornizë e disa me çmime për njësi. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim për kapitullin e detyrimeve.

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në IAP përbëhet nga një auditor (Drejtori i NJAB) i cili kishte të aprovuar planin vjetor dhe atë strategjik. Në vitin 2019 kishte planifikuar pesë auditime në fusha të vlerësuara sipas rrezikut.

NJAB kishte përfunduar tri raport për përmirësimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme ndërsa dy tjera ishin në proces të finalizimit. Nuk kemi ndonjë mangësi domethënëse për raportim në këtë fushë.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të IAP-së ka rezultuar në dy(2) rekomandime kryesore. IAP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, një rekomandim ishte zbatuar dhe një ishte në proces.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3.

⁴ Kjo shumë është prezentuar nga entiteti i audituar

Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Avokati i Popullit duhet të sigurohet që regjistri e-pasuria është duke kalkuluar zhvlerësimin dhe se prezantimi i tyre në PFV të jetë nga sistemi e-pasuria.	Menaxhmenti kishte ndërmarr masa për azhurnimin e e-pasurisë, mirëpo për shkak të problemeve në migrim të të dhënave nga platforma e vjetër në atë të re nuk kishte siguri lidhur me kalkulimin e zhvlerësimit, raportimi i tyre në PFV ishte bërë nga regjistri në excel.	Rekomandim i pjesërisht i adresuar.
2	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Avokati i Popullit duhet të sigurojë që menaxhimi i regjistrave bëhet në përputhje me rregulloren për menaxhimin e pasurive, përkatësisht të sigurojë largimin e pasurive jashtë përdorimit (tjetërsimit) sipas vlerësimeve të komisionit përkatës.	Nuk kemi identifikuar raste të tjera. Menaxhmenti ishte në proces të migrimit dhe azhurnimit të shënimeve në platformën e re të E-pasurisë.	I adresuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Avokati i Popullit duhet të sigurohet që procesi i migrimit të shënimeve është kryer më qëllim që regjistri e-pasuria të jetë funksional dhe ofron informata të sakta në PFV.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

7 maj 2020
Prishtinë,

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: “Etika-Co” SHPK

E/I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, ju njoftoj dhe konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiare për vitin 2019, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”), të Institucionit të Avokatit të Popullit.
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet, me që rast komentim për këtë çështje/gjeture e rekomandim ia bashkëngjitem kësaj leter konfirmimi; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

Me nderime,


Hilmi Jashari
Avokat i Popullit



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

7 maj 2020

Shtojaca III: Komentet e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) në draft raportin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të IAP për vitin 2019, lidhur me Gjetjen/Çështjen e CI për “Menaxhimi i pasurisë”.

Të gjeturat/çështjet	<i>Pajtohemi po/jo</i>	Komentet e IAP	Pikëpamjet e ZKA
Çështja/Gjetja CI – Mangësi në menaxhimin e sistemit të E-pasurisë” dhe raportimeve të tyre vjetore në PFV.	PO.	Me këtë gjetje pajtohem. Mirëpo kjo gjetje/çështje e kësaj mangësie në menaxhimin e sistemit të E-pasurisë dhe pastaj edhe të raportimeve në PVF ka qenë kryesisht e varur-ndikuar nga mos funksionalizimi i platformës të RE të E-pasurisë nga ana e kompanisë kontraktuese të ASHI-së, deri në fund të muajit dhjetor 2019. Kjo gjendje nga ndikuar në mos sigurimin dhe migrimin e plotë të pasurisë jo financiare të IAP në sistemin E-pasuria, përkundër angazhimit dhe marrjes të veprimeve nga ana e menaxhmentit dhe stafit të IAP në përfundimin e këtij migrimi dhe të funksionalizimit të E-pasurisë në platformën e re deri në fundvitin, si dhe për raportimin e tyre në PVF.	